REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1755/1 prot. Tiranë, më 19. 10. 2026

V E N D I M

Nr. 276, datë 19. 10. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi[1], bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, shqyrtoi ankesën nr. 249 Regj., datë 28.09.2026, të paraqitur nga I. M., kundër Entit Kombëtar të Banesave, Dega Rajonale Elbasan (në vijim EKB Elbasan), me pretendimin e diskriminimit për shkak të *"gjinisë", "gjendjes shoqërore", "gjendjes familjare", "gjendjes martesore" dhe "çdo shkaku tjetër"* (viktimizimi).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, subjekti ankues informon ndër të tjera se, që prej vitit 2020 ndodhet në procese gjyqësore civile dhe administrative që lidhen me apartamentin ku ajo banon. Aktualisht është palë paditëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 844/1997 të Bashkisë Elbasan, në të cilin figuron ish-vjehrri i saj, shtetasi H. T..

Në funksion të këtij procesi, ankuesja, personalisht dhe nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, i është drejtuar EKB Elbasan me disa shkresa (datë 04.02.2026, 23.02.2026, 03.06.2026 dhe me e-mail të datës 14.05.2026). Përmes tyre ka kërkuar informacion dhe vënien në dispozicion të dosjes administrative të apartamentit, duke përfshirë formularët e aplikimit të vitit 1997 dhe certifikatat familjare të kohës, si dhe një takim me përfaqësuesit e institucionit.

Nga dokumentacioni rezulton se EKB Elbasan ka kthyer përgjigje pjesërisht: me shkresën nr. 38/1 Prot., datë 13.02.2026, ka dërguar kopje të tre dokumenteve; më 02.03.2026 ka dhënë informacion mbi ekzistencën e kontratës së qirasë; ndërsa më 06.03.2026 ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit që lidhet me shtetasin H. T., me arsyetimin se mungon autorizimi i tij. Sipas

[1] Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

ankueses, kërkesa e datës 03.06.2026 nuk është kthyer më përgjigje dhe afati prej 10 ditë pune ka përfunduar më 18.06.2026.

Përfaqësuesi i ankueses i është drejtuar edhe Drejtorisë së Përgjithshme të EKB, e cila me shkresën nr. 1190 Prot., datë 17.07.2026, i ka kërkuar Degës Rajonale Elbasan të vërë në dispozicion të gjykatës dokumentacionin që disponon dhe të sigurojë komunikim korrekt e shterues me qytetarët. Sipas përgjigjes së EKB, datë 23.07.2026, dega ka depozituar në gjykatë dokumentacionin që disponon në arshivë.

Ankuesja pretendon se mosdhënia e informacionit dhe e dokumentacionit, refuzimi i takimit dhe pritja në zyrë e palës kundërshtare përbëjnë trajtim diskriminues të ndërthurur për shkak të gjinisë, gjendjes familjare, martesore e shoqërore, si dhe viktimizim për shkak të denoncimit publik që ajo ka bërë në vitin 2020.

Në përfundim, ankuesja, I. M., kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin dhe të detyrojë EKB Elbasan të ndërpresë këtë praktikë. Në ankesë theksohet se ajo "nuk ka për qëllim trajtimin e çështjes gjyqësore, por të sjelljes dhe veprimeve institucionale në lidhje me shërbimet dhe refuzimet publike".

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: "*Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi"*.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se pretendimet e ankueses kanë dy aspekte: së pari, mosdhënien e plotë të informacionit dhe të dokumentacionit të kërkuar nga EKB Elbasan dhe moskthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor; së dyti, pretendimin se ky qëndrim i institucionit përbën trajtim diskriminues ndaj saj, për shkak të gjinisë, gjendjes familjare, martesore e shoqërore, si dhe viktimizim.

Lidhur me pretendimin për mosdhënien e informacionit

Komisioneri vëren se pretendimi i ankueses, se EKB Elbasan nuk i është përgjigjur plotësisht dhe brenda afatit kërkesave të saj për informacion, ka të bëjë me zbatimin e ligjit nr. 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, të ndryshuar. Autoriteti mbikëqyrës për zbatimin e këtij ligji, pranë të cilit ankuesja mund të paraqesë ankim administrativ[2], është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP). Po ashtu, refuzimi i dokumenteve që lidhen me shtetasin H. T., me arsyetimin e mungesës së autorizimit të tij, prek çështje të mbrojtjes së të dhënave personale, të cilat janë gjithashtu në kompetencë të KDIMDP.

Për rrjedhojë, shqyrtimi i këtij pretendimi të ankueses nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara në nenin 32 të LMD[3]. Ndërkohë, çështja e paraqitjes së provave në procesin gjyqësor është në juridiksionin e gjykatës që shqyrton padinë, e cila, sipas dokumentacionit të paraqitur, ka urdhëruar tashmë EKB Elbasan të paraqesë dokumentacionin përkatës.

Lidhur me shkaqet e pretenduara

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me çdo pretendim për diskriminim, pala ankuese duhet të provojë, së pari, se shkaku i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe, së dyti,

[2] Neni 24, të këtij Ligji, parashikon se: *"Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, KDIMDHP ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. KDIMDHP merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se KDIMDHP nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk cenon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit".*

[3] Për analogji citojmë: Vendimin nr. 87, datë 14.04.2025, të KMD-së, Vendimin nr. 225, datë 19.08.2026, Vendimin nr. 210, datë 03.08.2026, Vendimi nr. 34, datë 11.02.2025, të KMD-së etj.

të parashtrojë fakte, indicie apo prova nga të cilat mund të prezumohet se ekziston një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë ka si bazë pikërisht shkakun apo shkaqet e mbrojtura të pretenduara. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet diskriminim i ndërthurur, për më shumë se një shkak. Vetë fakti që një person mbart një karakteristikë që përfshihet në një shkak të mbrojtur nuk mjafton, në vetvete, për të ngritur një pretendim të bazuar për diskriminim, në mungesë të dokumentimit të lidhjes shkakësore ndërmjet asaj karakteristike dhe trajtimit të pretenduar si të padrejtë.

Ankuesja ka pretenduar diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe gjendjes shoqërore, të cilat përfshihen shprehimisht ndër shkaqet e mbrojtura të renditura në nenin 1 të LMD. Ajo ka parashtruar se është grua e divorcuar, kryefamiljare dhe e mbijetuar e dhunës në familje. Megjithatë, identifikimi i këtyre shkaqeve nuk mjafton, në vetvete, për të provuar ekzistencën e diskriminimit. Ankuesja duhet të kishte sjellë fakte, indicie apo prova konkrete që të tregonin lidhjen shkakësore ndërmjet këtyre karakteristikave dhe trajtimit të pretenduar si të pafavorshëm nga EKB Elbasan.

Identifikimi i shkaqeve të mësipërme si shkaqe që, në parim, gëzojnë (ose mund të gëzojnë) mbrojtje ligjore, nuk mjafton, në vetvete, për të provuar ekzistencën e diskriminimit.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë ankuesja rezulton se EKB Elbasan i është përgjigjur disa herë kërkesave të saj (me shkresën nr. 38/1 Prot., datë 13.02.2026, me shkresën e datës 02.03.2026 dhe me e-mail të datës 06.03.2026), duke i vënë në dispozicion një pjesë të dokumentacionit. Refuzimi për pjesën tjetër është arsyetuar me mungesën e autorizimit nga shtetasi H. T., në emër të të cilit figuron dosja, pra me një arsye që nuk lidhet me gjininë, gjendjen familjare, martesore apo shoqërore të ankueses. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e EKB, pas ankesës së përfaqësuesit të ankueses, i ka kërkuar degës vënien në dispozicion të gjykatës të dokumentacionit dhe komunikim korrekt me qytetarët, ndërsa dega ka depozituar dokumentacionin në gjykatë.

Në këto kushte, parashtrimet e ankueses mbeten në nivel pretendimesh të përgjithshme, pa u shoqëruar me fakte, dokumente apo prova konkrete që të tregojnë se trajtimi i pretenduar si i pafavorshëm është pasojë pikërisht e shkaqeve të mbrojtura, e jo e faktorëve të tjerë (si procedurat për dhënien e informacionit apo mungesa e autorizimit të personit të tretë). Mbështetur në parashtrimet e ankueses, nuk mund të prezumohet se diferenca në trajtim e pretenduar ka si bazë shkaqet e mbrojtura, në kuptim të LMD.

Sa më sipër, në nenin 33, pika 4, shkronja "ç", të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, parashikohet se: *"4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim"*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja "ç", të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa nuk mund të pranohet dhe, për rrjedhojë, nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj. Për pretendimet që lidhen me të drejtën e informimit, ankuesja mund t'i drejtohet KDIMDP.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranim e ankesës së I. M., për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e saj, të përcaktuara nga ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar.
2. T'i rekomandojë ankueses, I. M., t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për shqyrtimin e pretendimeve të saj mbi mosdhënien e informacionit dhe të dokumentacionit nga Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Elbasan, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

(Shkaqet: gjinia, gjendja familjare, martesore e shoqërore, si dhe viktimizim)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)